



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS
BADMINTON SAVEZ KOSOVO
BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO

Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;
Shtëpia e sporteve Rr.“Agim Ramadani” pn, 10000 Prishtinë
www.badminton-rks.org, email:b.f.kosovo@gmail.com

Field Code Changed

RREGULLORE

MBI PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS

20252

Në përputhje me nenin 15 paragrafin 2.1 dhe nenin 18 paragrafin 7 të Statutit të Federatës së badmintonit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Badmintonit të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur në shtëpinë e sporteve në Prishtinë më datën ~~05.11.2022~~ 26.03.2025 aprovoi:

RREGULLOREN

MBI PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS

I.DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Me këtë rregullore të punës rregullohet mënyra e punës së Këshillit Mbikqyrës të Kuvendit të Federatës së Badmintonit të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli Mbikqyrës).

Neni 2.

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përgatiten, caktohen dhe mbahen mbledhjet e Këshillit mbikqyrës të BFK -së dhe realizohen autorizimet dhe obligimet e tij.

Neni 3.

Këshilli mbikëqyrës i BFK - së përbëhet nga 3 anëtarë, ekspert të fushave të caktuara, të cilët i zgjedh Kuvendi.

Neni 4

Këshilli ka Kryetarin, të cilin nga radhët e veta e zgjedhin anëtarët e Këshillit.

Neni 5

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjatë 4 vite me mundësi vazhdimi edhe për 1 (nje) mandat.

Mandati i anëtarëve të Këshillit mund të pushoi edhe para skadimit të mandatit në këtoraste:

- dorëheqja nga anëtari i Këshillit,
- shkarkimi i tij,
- me shkapërderdhjen e organizatës,
- me vdekje,
- në rastet tjera të parapara me Ligj dhe Statut.

II.FUSHËVEPRIMI

Neni 5.

Fushëveprimi i Këshillit mbikëqyrës të BFK -së është:

- mbikëqyrë zbatimin e Statutit dhe të akteve tjera normative,
- mbikëqyrë gjendjen materialo-financiare,

- mbikëqyrë shfrytëzimin e pasurisë së BFK - së,
- mbikëqyrë zbatimin e Vendimeve, konkluzave dhe akteve tjera juridike.
- kryen edhe punë tjera që ia beson Kuvendi.

III.MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKQYRËS të BFK –së

Neni 6.

Keshilli Mbikqyrës i BFK -së në mbledhjet e veta nxjerr Vendime, Konkluzione, Qëndrime, jep mendime, nis iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme.

Neni 7.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës të BFK - së mbahen sipas nevojës.

Neni 8.

Në mbledhjet e Këshillit mbahet procesverbali.

Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai.

Procesverbalin e nënshkruan Procesmbajtësi dhe Kryetari.

Neni 9.

Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës e thërret Kryetari..

Neni 10.

Për mbledhje të Këshillit ftohen gjithmonë të gjithë anëtarët.

Neni 11.

Prania në mbledhje është e obligueshme.

Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, ai ka për obligim që tanjoftoi Kryetarin.

IV. MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKQYRËS të BFK –së

Neni 6.

Keshilli Mbikqyrës i BFK -së në mbledhjet e veta nxjerr Vendime, Konkluzione, Qëndrime, jep mendime, nis iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme.

Neni 7.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës të BFK - së mbahen sipas nevojës.

Neni 8.

Në mbledhjet e Këshillit mbahet procesverbali.
Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai.
Procesverbalin e nënshkruan Procesmbajtësi dhe Kryetari.

Neni 9.

Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës e thërret Kryetari..

Neni 10.

Për mbledhje të Këshillit ftohen gjithmonë të gjithë anëtarët.

Neni 11.

Prania në mbledhje është e obligueshme.
Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, ai ka për obligim që tanjoftoi Kryetarin.

V.PUNA NË MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Neni 12.

Këshilli Mbikqyrës i BFK - së punon dhe vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse nëmbledhje prezantojnë të gjithë anëtarët.

Neni 13.

Për secilën pike të rendit të ditës bëhet shqyrtim i veçantë dhe sipas radhitjes së miratuar.

VI VENDIMET DHE VOTIMI

Neni 14.

Vendimet e Këshillit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve.

VII.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15.

Punët administrativo-teknike për nevojat e Këshillit Mbikqyrës i bën Sekretaria e Organizatës .

Neni 16.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit.
Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës siç është aprovuar më parë.

Prishtinë

~~05.11.2022~~

~~26.03.2025~~



~~Përfaqësues i autorizuar i BEK-së~~